



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 608/16 Prot

Shkodër, më 13.02. 2025

Lënda : Dërgohen të dhëna mbi treguesit e transparencës dhe llogaridhënies së Këshillit Bashkiak Shkodër 2024.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT FINANCIAR

Në zbatim të e-mailit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, po ju dërgojmë të dhënat për Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe konsultimet publike të realizuara.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbështetje dhe zbatim të nenit 16, 18, 54 shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, nenit 77, shkronja “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut , publikon në faqen web të Bashkisë Shkodër çdo vendim të miratuar në cilësinë e organit vendim-marrës. Konkretisht për vitin 2024 janë miratuar dhe publikuar në faqen e zyrtare të Bashkisë 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) Vendime, të bazuara në propozimet e ardhura nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilltarë.

Gjatë vitit 2024, Këshilli Bashkiak ka miratuar gjithsej 5 (pesë) vendime , për të cilat bazuar në legjislacionin në fuqi kanë kaluar paraprakisht në fazën e konsultimit me publikun. Vendimet janë me propozim të Kyetarit të Bashkisë dhe kanë të bëjnë me procese vendim-marrëse sa i takon Buxhetit të Bashkisë , Plane, Rregullore etj . Njoftimet dhe publikimet janë kryer brenda kërkesave dhe afateve ligjore, janë mbajtur procesverbalet përkatëse të konsultimit.

Procesverbalet dhe çdo material lidhur me konsultimet i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë: <http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-projekt-akteve/>

Janë zhvilluar këto dëgjesa publike:

1. Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Shkodër.

Zhvilluar gjithsej 12 takime, pjesëmarrës 488, nga të cilët 97 gra dhe vajza .

Konkretisht janë mbajtur dhe publikuar procesverbalet e mëposhtme :

Procesverbal datë 26.09.2024 ora 15:00, Konsultimin Publik, me Lagjen Nr. 5. Numri i pjesëmarrësve 43 , nga të cilat 10 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 25.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Lagjen Nr. 4. Numri i pjesëmarrësve 59 , nga të cilat 16 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 24.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Lagjen Nr. 3. Numri i pjesëmarrësve 34 , nga të cilat 9 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 23.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Lagjen Nr. 2. Numri i pjesëmarrësve 30 , nga të cilat 7 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 20.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Lagjen Nr. 1. Numri i pjesëmarrësve 17 , nga të cilat 6 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 19.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Gur i Zi. Numri i pjesëmarrësve 31, nga të cilat 3 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 18.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Postribë. Numri i pjesëmarrësve 26, nga të cilat 4 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 17.09.2024 ora 15:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Bërdicë. Numri i pjesëmarrësve 54, nga të cilat 7 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 16.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Dajç. Numri i pjesëmarrësve 30 nga të cilat 5 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 13.09.2024 ora 13:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Velipojë. Numri i pjesëmarrësve 30 nga të cilat 4 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 12.09.2024 ora 15:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Ana e Malit . Numri i pjesëmarrësve 41 nga të cilat 7 gra dhe vajza;

Procesverbal datë 11.09.2024 ora 15:00, Konsultimin Publik, me Nj. Administrative Njësia administrative Rrethina, Pult, Shalë, Shosh Numri i pjesëmarrësve 93 nga të cilat 19 gra dhe vajza;

2. Caktimi i zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër.

Numri i pjesëmarrësve 14, nga të cilat 7 gra dhe vajza.

3. Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia Shkodër 2024.

Numri i pjesëmarrësve 12, nga të cilat 2 gra dhe vajza.

4. Për Miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Shkodër.

Numri i pjesëmarrësve 59, nga të cilat 49 gra dhe vajza.

5. Për miratimin e “Planit vendor të mbrojtjes së Biodiversitetit”

Numri i pjesëmarrësve 9, nga të cilat 5 gra dhe vajza.

6. Miratimi i “Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit në territorin e Bashkisë Shkodër”.

Numri i pjesëmarrësve 13, nga të cilat 2 gra dhe vajza.

7. Për miratimin e “Planit vendor të veprimit për energji dhe klimë”.

Numri i pjesëmarrësve 22, nga të cilat 9 gra dhe vajza .

8. “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve vendorë të nderit dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Shkodër”.

Numri i pjesëmarrësve 9, nga të cilat 3 gra dhe vajza .

Procesverbalet dhe çdo material lidhur me mbledhjet e zhvilluara të Këshillit i gjeni të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër :

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistrirbashkiashkoder/regjistri-i-mbledhjeve-te-keshillit-bashkiak/>

Gjatë vitit 2024 nuk ka patur asnjë petition apo iniciativë qytetare.

Këshilli bashkiak në mbledhjen e tij të parë pas zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ndër të tjera ka miratuar dhe vendimet përkatëse për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendës-kryetarëve të këshillit. Këshilli bashkiak përbëhet nga Kryetari (burrë) dhe dy zëvendës-kryetarë (gra).

Gjithashtu në vendimin për zgjedhjen e anëtarëve që përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut, numri i grave është 4 (katër), nga përbërja prej 7 anëtarësh.

Sa i përket komisioneve të këshillit bashkiak, mbështetur në vendimin e këshillit bashkiak Nr.60, datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër”, këshilli organizon punën e tij nëpërmjet 17 komisioneve, ku në përbërje janë 8 (tetë) gra në cilësinë e kryetares së komisioneve përkatëse.

Këshilli Bashkiak ka një rol të rëndësishëm në administrimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave nga qytetarët dhe grupet e interesit. Për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien, të gjitha këto kërkesa dhe ankesa regjistrohen. Në përputhje me kërkesat për

transparencë, të gjitha këto kërkesa janë të disponueshme në një regjistër të hapur dhe publik, ku çdo qytetar ka mundësinë të konsultohet me statusin e tyre. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të siguruar se proceset janë të drejta dhe të qarta, dhe që qytetarët mund të ndjekin përparimin e kërkesave të tyre.

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/>

Duke Ju falënderuar,

SEKRETARE

Sabina Danaj

